

23/1 prot  
20.02.2012



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME

Drejtoria e Përgjithshme  
e  
Policisë së Shtetit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA  
DISKRIMINIMI

Nr. 468/2 Prot, datë 17.02.2012

Nr. 23 Prot, datë 16.01.2012

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

dhe

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

## **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

**dhe**

### **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**

**Me synimin** e përbashkët për respektimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

**Me qëllimin** për të kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në procesin e bashkëpunimit dypalësh për parandalimin e diskriminimit, respektimin dhe garantimin e të drejtave të njeriut gjatë veprimtarisë për përmbushjen e misionit dhe të përgjegjësive ligjore të dy institucioneve, në përputhje me zbatimin e legjislacionit respektiv të secilit institucion;

**Me objektiv** garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sigurimin e të drejtës së çdo personi për, brarazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat e për të gëzuar liritë, për mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, sipas fushës së veprimtarisë që ato mbulojnë;

**Me angazhimin** për të bashkëpunuar me njeri-tjetrin mbi bazën e parimit të reciprocitetit;

**Bazuar në** Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 8137 , datë 31.07.1996 " Për ratifikimin e Konventes Evropiane "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", Ligj nr.9264, datë 29.07.2004 "Për Ratifikimin e Protokollit nr.12 të Konventës "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", Ligj nr.7767, datë 09.11.1993 "Për Aderimin në Konventën "Për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave", Ligj nr.7768, datë 09.11.1993 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare "Për Zhdukjen e të Gjitha Formave të Dallimit Racor", Ligj nr.8496, datë 03.06.1999 "Për ratifikimin e "Konventës kuadër të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve", Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Ligjin Nr. 9749, datë 04.06.2007, "Për Policinë e Shtetit", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (me poshtë te referuara palët),

**Palët,**

Bien dakort si më poshtë:

### **Neni 1**

#### **Objekti i Marrëveshjes**

1.1 Kjo marrëveshje ka për objekt ndalimin e sjelljeve diskriminuese dhe përcaktimin e rregullave e modaliteteve brenda të cilave Palët do të zhvillojnë marrëdhëniet ndërmjet tyre, për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike dhe marrjen e masave për mbrojtjen nga

